

I. Misioni

Misioni i Bashkinë PUSTEC

Sigurimin e një qeverisje të efektshme,efikase, në një nivel sa më afër komunitetit nëpërmjet

- Njohjes së vlerave të bashkisë .
- Zgjidhjes dhe ofrimit të llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe krijimi i lehtësirave të tjera publike në dobi të komunitetit
- Ushtrimit efektiv të funksioneve ,kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetqeverisjes vendore.
- Realizimit të shërbimeve në forma të përshtatëshme , bazuar në nevojat e komunitetit .

Dhe në përputhje me standartet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative .

II. Shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet puna dhe synimet e saj që të jenë si më poshtë:

- Zhvillimi ekonomik i bashkise
- Zhillimi i agro turizmit dhe i turizmit
- Nxitja e punësimit dhe sipërmarjes në agroturizëm
- Ofrimi i shërbimeve cilësore
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore rurale
- Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes
- Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive,
- Rehabilitim i objekteve arsimore ,administrative,sociale

III. Objektivat kryesore të Bashkisë Pustec kanë të bëjnë me :

1. Hartimin dhe menaxhimin e projekteve të zhvillimit strategjik të cilit do të realizohen me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare dhe donatorëve të ndryshëm .
2. Krijimin e standartit të lartë të komunikimit me publikun, vlerësimin e problematikave ,ndjekjen dhe zgjidhjen përfundimtare të tyre duke afruar shërbime maksimale ndaj komunitetit .

IV. *Vizioni i bashkise ;*

Bashkia Pustec; do të jetë një model i zhvillimit të qëndrueshëm, ku popullata lokale do të ketë cilësi jetese të lartë dhe marrëdhënie harmonike me natyrën, në ruajtjen dhe promovimin e Parkut – si pasuria më e madhe lokale mbi të cilën zhvillohet ekonomia lokale, lidhur ngushtësisht me zhvillimin e turizmit dhe bujqësisë. Shërbime publike

cilësore, infrastruktura bashkëkohore në funksion të mbrojtjes së pasurive natyrore dhe partneriteti lokal ndërmjet aktorëve të të gjithë sektorëve përbëjnë bazat e arritjes së kohezionit social dhe ekonomik të territorit në terma afatgjatë;